



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura e –III-

**KOMISIONI PARLAMENTAR PËR BUJQËSI, PYLLTARI,
ZHVILLIM RURAL, MJEDIS DHE PLANIFIKIM
HAPËSINOR**

Procesverbal **Nr. 9**
nga mbledhja e mbajtur më **6.5.2008**
kryesuar nga **Lulzim Zeneli**-kryetar i komisionit
Mbledhja filloi në orën 14,00

Të pranishëm :

Lulzim Zeneli kryetar i Komisionit, Berat Luzha, Selvie Halimi, Heset Cakolli , Myrvete Pantina, Ali Lajçi, Kosara Nikolić, Elheme Hetemi.

Munguan :

Zef Morina, Zylfi Merxha, Ibrahim Selmani.

Nga Sekretaria e Kuvendit : Bajram Badivuku, Lule Ymeri dhe Drita Çarkaxhiu.

Pjesëmarrësit tjerë : përfaqësuesi nga Asoc. i Komunave z. Lamaj, nga MMPH Muhamet Aliu, Jashar Kastrati dhe Tirana Baftiu.

RENDI I DITËS U MIRATUA PA VËREJTJE :

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Projektligji për Shitjen e Banesave...,
3. Të ndryshme

Procesverbali

Procesverbali nga mbledhja e kaluar u kundërshtua nga **Berat Luzha** në pasusin kur hartuesi ka shënuar në diskutimin e kryetarit të komisionit “Selvie Halimi dhe Berat Luzha përkundër argumenteve të logjikshme të kryetarit...”, me çka u konstatua se hartuesi nuk duhet të jap komente gjatë hartimit të shkresës siç është procesverbali.

Hartuesi u përgjigj se ky “konstatim” i cituar në fakt është diskutimi i Selvie Halimit, ndaj shkaku pse dy anëtarët janë apostrofuar është se diskutimet e tyre kanë qenë të ngjashme. **Selvije Halimi** komentoi diskutimin e saj me domethënie pak më ndryshe se si është shkruar, dhe bashkërisht me Berat Luzhën kërkuan që mbledhjet të transkriptonen. **Ali Lajçi** gjithashtu tha se nuk është hartuar si duhet diskutimi i tij. Kryetari **Lulzim Zeneli** në emër të komisionit nxori këtë :

P Ë R F U N D I M

- 1. Deri në mbledhjen e radhës të komisionit, anëtarët e komisionit të cilët kanë vërejtje në procesverbal, të propozojnë ndryshimet me shkrim , për të cilat do të vendosë komisioni, ndërkaq hartuesi i procesverbalit, në të ardhmen mos të komentojë diskutimet e anëtarëve të komisionit.**
- 2. Nga Kryesia e Kuvendit të kërkohet transkriptimi i mbledhjeve të këtij komisioni.**

Projektligji për Shitjen e Banesave...

Kryetari **Lulzim Zeneli** në fillim iu rikujtoi të pranishmëve se lidhur me këtë projektligj komisioni ka kërkuar nga MMPH të jap propozimin për nenet që përcaktojnë vlerën e banesës, por paraprakisht komisioni miratoi amendamentin e riformuluar të **Gani Kocit**, e cila në radhitjen përfundimtare do të shkoi me mbështetje të komisionit :

Amendamentit 1 (përkatësisht Nenit 1) të komisionit i shtohet paragrafi 2, ndërsa teksti ekzistues i Nenit 1 bëhet paragrafi 1 :

“Përveç banesave të trajtuara në paragrafin ekzistues të këtij neni, me të njëjtën të drejtë për shitje trajtohen edhe banesat të cilat kanë filluar të ndërtohen para luftës, me mjete të fondeve të përbashkëta të ndërmarrjeve publike ose shoqërore, dhe që kanë përfunduar pas luftës. “

Në vazhdim **Muhamet Aliu** njoftoi komisionin lidhur me propozimin e MMPH për vlerën e banesave dhe shpërndau propozimin me shkrim. Ai, përveç që sqaroi çmimin propozues prej 100 eurosh për metër, propozoi të shtohet një pikë neni 19 sa i përket vjetërsisë së banesave (30 vjet) të cilat do të shiten. Meqenëse komisioni në vazhdim konstatoi disa paqartësi rreth vlerës së pjesëve të banesës që gjenden brenda një banese ose jashtë, siç janë garazha, ballkoni, podrumi etj , u kërkua që grupi punues e përbërë nga **Selvije Halimi, Kosara Nikoliq, Heset Cakolli, Muhamet Aliu dhe z. Lamaj nga Asoc. i Komunave** të takohen edhe një herë para se të takohet komisioni të premtën rreth këtyre çështjeve, grup i cili do të propozoi komisionit zgjidhjet e mundshme. Komisioni miratoi disa vërejtje-amendamente, por ato do të paraqiten në mbledhjen e radhës si përfundimtare lidhur me këtë projektligj.

Të ndryshme

Kryesuesi Lulzim Zeneli në këtë pikë propozoi komisionit të shqyrtohet mundësia e vazhdimin të punës së komisionit rreth projektligjit për ushqimin përkundër faktit se nuk ka përgjegje në shkresën e dërguar Zyrës së Kryeministrit. Njëherit njoftoi për takimin

me zyrtarët e USAID-it të cilët kanë dhënë disa propozime rreth projektligjit për Tokën Ndërtimore, e cila nëse vazhdohet të shqyrtohet nga komisioni do të ketë nevojë për mjaftë përmirësime të bëhen në të.

Berat Luzha kishte vërejtje në punën e komisionit e cila nuk mban takime sipas agjendës që kërkohet, ngase ka mjaftë projektligje që presin të shqyrtohen, propozoi që komisioni të mbaj dy mbledhje në javë me qëllim që të mbërijë dinamikën e dëshiruar. Gjithashtu propozoi të bëhen dy vizitat e kërkuara më heret nga komisioni, vizitat në MMPH dhe MBPZHR me qëllim të koordinimit të punëve.

Konstatimit të Berat Luzhës **Lulzim Zeneli** i shtoi edhe faktin se përpos që ky komision ka agjendën e ngjeshur , ka edhe projektligje “problematike” të cilat në vedit kanë edhe probleme të cilat duhen zgjidhur paraprakisht, para se të amendamentohen, ndaj sugjeroi që komisioni këtë çështje të shqyrtoi në takimin e së premtës. Komisioni nxori :

K O N K L U D I M

Në mbledhjen e komisionit e cila do të mbahet të premtën më 9 maj , të shqyrtohen dhe të përfundohen projektligji për ushqimin dhe ajo për banesat, ndërsa për takimin e radhës pas të premtës të radhitet projektligji për Mbrojtjen e Mjedisit , e cila gjithashtu është e kompletuar për shqyrtim të mëtejme.

Nga Zyra e Kryeministrit të kërkohet përgjegjja deri të premtën rreth shkresës së dërguar nga Komisioni për Agjensionin e Ushqimit, në mënyrë që komisioni, pas eliminimit të dilemës së cekur në shkresë, të vazhdoi shqyrtimin e amendamenteve të cilat janë të gatshme nga legjislacioni i dytë.

Mbledhja përfundoi në orën 15,10.

Bajram Badivuku
Admin. i Komisionit,

Kryetari i Komisionit,
Lulzim Zeneli